



Pranimi / Dostizna Primitje / Prodato Received / Privately	08.12.2023	3	viti god Year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	SKIMSHCK	7366/2023	114
Hi Prot Hi Prot Prot. No			
Shtepia Protig Appendix			
Sasia Kantina Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1284/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1284/2023 të datës 13.10.2023, të parashtruar nga ankuesja

për shkak të heshtjes së Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 1, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1284/2023, e datës 13.10.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, (tutje referuar ankuesja), më datë 13.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, par shkak të heshtjes së Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me kërkesën e ankueses të datës 21.08.2023, për kompensim të shtesave të IT-së, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1150/2019 të datës 13.02.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (këtu e tutje vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 20.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 1284/2023 të datës 13.10.2023; të parashtruar në KPMShCK; Kërkesën e ankuesit me numër protokolli 05-5099, të datës 21.08.2023 drejtuar Drejtorit të SISH-it; Kërkesën e ankueses me numër protokolli 149, e datës 16.11.2018 drejtuar Drejtorit të SISH-it; Aktgjykimin A.nr.1150/2019, i datës 13.02.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin Nr.07/29, i datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/39, i datës 08.10.2008, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1284/2023, të datës 23.10.2023, së bashku me provat e bashkangjitura si: Akt Emërimi me numër protokolli 137, i datës

30.09.2013 i ankuesit; Vendimi me numër protokollit 4151, i datës 27.12.2018, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Fushën e Teknologjisë Informativë; Kërkesë me numër protokollit 05-2101 e datës 29.03.2021 nga ankuesja për Drejtorin e SISH-it; shkresë-Cv e ankueses, Diplomë me numër protokollit Nr. 261, e datës 05.05.2010 e ankuese; Certifikatë e trajnimit e datës 28.02.2020, Certifikatë e trajnimeve e datës 04.05.2020; Certifikatë e trajnimit e datës 01.06.2020; Certifikatë e trajnimeve e datës 16.06.2020; Certifikatë e trajnimit e datës 03.11.2020; Certifikatë për trajnim IINS e datës 02.10.2019; Certifikatë e trajnimeve CCNAX e datës 26.07.2019; Certifikatë e trajnimit tetor 2019; Certifikate për vijim të trajnimit për Storage EMC Vmax-10 K; Certifikatë e trajnimeve për periudhën 09.11.2009 deri me 20.11.2010; Certifikatë e trajnimeve për periudhën 01.12.2009 deri me 15.12.2009; Certifikatë e trajnimeve për periudhën 23.11.2009 deri me 26.11.2009; Certifikatë e trajnimit e datës 24.12.2009; shkresë e datës 24.12.2009 e lëshuar nga CISCO, Certifikatë e trajnimit e datës 2.04.2009; shkresë e datës 06.04.2009 nga CISCO; Certifikatë e trajnimit e datës 12.10.2009 të lëshuar nga IKAP, Certifikatë për ndjekje të trajnimit Modern HR Managment, Certifikatë MLDD-601-21 të lëshuar nga Qendra e Kosovës për Siguri Publikë, Edukim dhe Zhvillim; Certifikatë e trajnimit për periudhën 01.12.2009 deri me datë 15.12.2009; Certifikatë e trajnimit për periudhën 30.04-22/06/2007; Certifikatë e trajnimit për periudhën 30.04-22/06/2007; Certifikatë e trajnimit për periudhën 18.09/06-17/10/06; Certifikatë e trajnimit e datës 22.11.2005; Certifikatë e trajnimit e datës 27.11.2015; Certifikatë e trajnimit e datës 13.08.2003; Certifikatë e trajnimit e datës 06.05.2003; Certifikatë e trajnimit e datës 21.06.2005; shkresë e datës 13.05.2006 e lëshuar nga OSCE; Shkresë e datës 30.11.2005 e lëshuar nga OSCE dhe UNMIK; shkresë me numër 603 e datës 19.01.2009 lidhur me aprovimin e shtesave për kategori të veçanta profesionale-deficitare; provat nga sistemi elektronik i KPMSHCK lidhur me ankesën A.nr. 216/2019 të datës 25.03.2019 si: Ankesa me numër të protokollit 1561/2019 e datës 25.03.2018; ankesa me numër protokollit 05-1147 e datës 12.03.2019; ankesa me numër protokollit 05-1151 e datës 12.03.2019; ankesa me numër protokollit 05-1150 e datës 12.03.2019; email nga KZKA i datës 20.03.2019 si dhe Njoftimi i Këshillit më numër të protokollit 3786/2019 i datës 22.08.2019.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të të gjitha provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e pabazuar ankesa e ankuese, sepse;

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit nr.137 të datës 01.10.2013, është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës Administratore për Qendrën Operative të IT SISH, në Divizionin e Sistemit të Informimit Shëndetësor.

Me tej nga provat e lëndës rezulton se më datë 16.11.2018, Ministria e Shëndetësisë ka parashtruar kërkesë të Komisioni kompetent i themeluar në atë kohë në Ministrinë e Administratës Publike, për aprovimin e shtesës në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në fushën e IT-së, dhe atë për zyrtarët .

Ndërsa, Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave për shtesa në pagë në fushën e IT-së, përmes Vendimit më numër të protokollit 4151 të datës 27.12.2018, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë të datës 16.11.2018. duke aprovuar shtesat në pagë në fushën e IT-së për zyrtarët

kyrtaren . Kurse shtesa në fjalë nuk ishte aprovuar për ankuesen dhe

Për arsye të mos ekzekutimit të vendimit me numër të protokollit 4151 të datës 27.12.2018 , të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për shtesa në pagë në fushën e IT-së, zyrtarët sipas këtij vendimi kanë parashtruar ankesë fillimisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa, më datë 25.03.2019, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Ky i fundit në mungesë të kuorumit për vendosje të ankesës së ankuesve, ka udhëzuar të njëjtit përmes shkresës me numër të protokollit 3786/2019 të datës 22.08.2019, për të drejtën e hapjes së konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Po nga shkresat e lëndës, rrjedhë së Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativë, me aktgjykimin A.nr.1150/2019 të datës 13.02.2023, ka aprovuar padinë e ankuesve duke obliguar Ministrinë e Shëndetësisë që të bëjë kompensimin e shtesës në paga në fushën e IT, sipas Vendimit me numër 4151 të datës 27.12.2023 si dhe kamatën prej 8%.

Ankuesja më datë 21.08.2023, parashtron kërkesë të organi i punësimit për miratim të shtesës së IT-së, në mënyrë analogu sikurse kolegëve të Departamentit të SISH, duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër 1150/19 të datës 13.02.2023, e më të cilin aktgjykim është miratuar kërkesa e për shtesa në pagë të IT-së. Pas heshtjes së organit të punësimit ndaj kërkesës së ankueses të datës 21.08.2023, ankuesja ushtron ankesë në Këshill, po me pretendimin e njëjtë gjegjësisht që ankueses ti njihet e drejta në shtesa të IT-së sikurse kolegeve të saj duke u bazuar në aktgjykimin A.nr.1150/19 të datës 13.02.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në kontest të bazushmerisë së pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit iu referuar Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, i aplikueshëm në kohën e nxjerrjes së Vendimit Nr. 4151 të datës 27.12.2023, të Komisionit për Shqyrtimin e kërkesave për shtesat në pagë në fushën e IT-së, e mbi bazën e të cilit vendimi, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit A.nr.1150/19 të datës 13.02.2023, rrjedhimisht, me theks të veçantë Kolegji analizoi nenin 50 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.* 2. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezultojnë nga një veprim i administratës publike”* si dhe nenin 81 të të njëjtit ligj, me të cilin përcaktohej se: 1. *Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë.* 2. *Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”* e si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton së nëpunësit civilë fillimisht kanë pasur të drejtë ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë institucionit të punësimit, e më pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Rrjedhimisht, nisur nga ky përcaktim ligjor si dhe bazuar në provat materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit ka gjetur së ankuesja përkundër së me vendimin me numër të protokollit 4151 të datës 27.12.2018 të Komisionit të MAP, nuk i është njohur e drejta në shtesa të IT-së, e njëjta nuk kishte ndërmarr asnjë veprim juridik për të kundërshtuar këtë vendim, përkatësisht e njëjta nuk kishte parashtruar ankesë të brendshme dhe po ashtu as në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Andaj, duke qenë se ankuesja ka lëshuar ndërmarrjen e veprimeve juridike në procedurë administrative për të kundërshtuar vendimin me numër të protokollit 4151 të datës 27.12.2018 të Komisionit të MAP-IT, dhe meqenëse me aktgjykimin e Gjykatës Themelore A.nr. 1150/19 të datës 13.02.2023, mbi të cilën ankuesja ka bazuar pretendimet ankimore, e drejta e kompensimit të shtesës së IT-së sipas vendimit me numër të protokollit 4151 të datës 27.12.2018, nuk i është njohur ankueses por vetëm zyrtareve të cilët kanë qenë palë paditëse sipas padisë së datës 15.05.2019, rezultojnë se nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankueses për kompensim të shtesës së IT-së bazuar në aktgjykim A.nr. 1150/19 të datës 13.02.2023.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1284/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës



Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

